

Tekst i konsoliduar

Në bazë të nenit 158-s pika 1 dhe neni 209 dhe në lidhje me nenin 160 të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimit – tekst i konsoliduar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.30/2012), Vendim i Gjykatës Kushtetuese me Nr. 202/2011 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” Nr. 45/2012), Vendim i Gjykatës Kushtetuese me Nr. 130/2011 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” me Nr. 60/2012), Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 122/2011 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” me Nr. 64/2012), Vendim i Gjykatës Kushtetuese me Nr. 129/2011 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” me Nr.23/2013), Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë të Mbikëqyrjes të Sigurimeve miratoi:

RREGULLORE PËR VEPRIMET BAZË, RREGULLAT DHE MËNYRËN E ZBATIMIT TË MBIKËQYRJES SË SIGURIMIT¹

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

(1) Me këtë rregullore përcaktohen veprimet bazë, rregullat dhe mënyra e zbatimit të mbikëqyrjes së sigurimit të shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit në sigurim, shoqërive për përfaqësim në sigurime dhe bankave që ushtrojnë aktivitetin e përfaqësimit në sigurime (në tekstin që vijon: shoqëri) dhe në mënyrë më të detajuar rregullohen kompetencat e personave të autorizuar nga ana e Agjencisë të Mbikëqyrjes të Sigurimeve (në tekstin që vijon: mbikëqyrës) për zbatimin e mbikëqyrjes përmes:

- Mbikëqyrjes së përhershme off-site të veprimtarisë së shoqërisë përmes kontrollit të raporteve dhe dokumentacionit tjetër të cilin shoqëria e dorëzon tek Agjencia e Mbikëqyrjes të Sigurimeve (në tekstin që vijon Agjencia) në bazë të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve, Ligjit për Sigurim të

¹ Teksti i konsoliduar i Rregullores është përgatitur në bazë të tekstit të Rregullores për veprimet bazë, rregullat dhe mënyrën e zbatimit të mbikëqyrjes së sigurimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 9/2014) dhe Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për veprimet bazë, rregullat dhe mënyrën e zbatimit të mbikëqyrjes së sigurimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 59/2017) Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për veprimet bazë, rregullat dhe mënyrën e zbatimit të mbikëqyrjes së sigurimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 63/2021). Teksti i konsoliduar nuk ka fuqi juridike. Për qëllime juridike, të vlefshëm janë vetëm raportet të cilat janë botuar në Gazetat Zyrtare të theksuara më parë.

Detyrueshëm në Transport, aktet nënligjore dhe rregulla të tjera të miratuara në bazë të këtyre ligjeve (në tekstin që vijon: rregullativa);

- Mbikëqyrje në terren (e plotë apo e pjesëshme dhe shtesë) e veprimtarisë së shoqërive përmes kontrollit të menjëhershëm të drejtpërdrejtë dhe shqyrtim në veprimtarinë e shoqërisë, regjistrat e saj të punës dhe evidenca tjetër e punës;
- Përcaktimi i masave të mbikëqyrjes;
- Mbajtje e kontaktit me anëtarët e organeve të udhëheqjes së shoqërive dhe me shoqëritë për auditim dhe
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave dhe informatave me organe të tjera mbikëqyrëse dhe institucione të tjera të huaja dhe të vendit.

(2) Dispozitat nga kjo rregullore aplikohen edhe gjatë zbatimit të mbikëqyrjes së filialit të shoqërisë të sigurimeve nga Republika e Maqedonisë së Veriut në shtet anëtar apo shtet të huaj, ushtrimi i drejtpërdrejtë i veprimtarive të sigurimeve të shoqërisë për sigurim nga Republika e Maqedonisë së Veriut në shtet anëtar, filiale të shoqërisë të sigurimeve nga shteti anëtar i Bashkimit Evropian, filiale të shoqërisë të sigurimeve nga një shtet i huaj, si dhe ushtrimi i drejtpërdrejtë e veprimtarive të sigurimeve nga ana e shoqërisë të sigurimeve nga shteti anëtar i Bashkimit Evropian.

(3) Dispozitat e kësaj rregulloreje aplikohen edhe gjatë zbatimit të mbikëqyrjes së:

- Byrosë Kombëtare të Sigurimeve;
- personave të lidhur me shoqëritë;
- personave me të cilët shoqëria ka lidhur kontratë për transferim të aktiviteve të jashtme;
- përfaqësuesit në sigurim dhe brokerëve në sigurim dhe
- personave të cilët pa leje të Agjencisë ushtrojnë veprimtari të sigurimeve, veprimtari brokerimi në sigurime dhe veprimtari të përfaqësimit në sigurime.

(4) Mbikëqyrës, në përputhje me këtë rregullore, janë persona të cilët janë të punësuar në Agjenci të cilët:

- në bazë të autorizimit nga kryetari/anëtari i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë, zbatojnë mbikëqyrje në terren të veprimtarisë së shoqërisë dhe subjekteve të tjera të mbikëqyrjes dhe
- angazhohen në ushtrimin e detyrave të punës për grumbullimin, kontrollin dhe analizën e

raporteve dhe të dhënave të cilat shoqëria dhe subjektet e tjera të mbikëqyrjes janë të detyruar t'i dorëzojnë Agjencisë në përputhje me dispozitat nga rregullativa.

(5) Mbikëqyrësit, në përputhje me këtë rregullore, mund të jenë edhe persona të cilat nuk janë të punësuar në Agjenci ndërsa të cilët në bazë të autorizimit të veçantë nga kryetari/anëtari i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë janë të autorizuar të zbatojnë mbikëqyrje të pjesëve të veçanta të veprimtarisë së shoqërive dhe subjektet e tjera të mbikëqyrjes.

PËRMBAJTJE DHE PËRFSHIRJE E MBIKËQYRJES

Neni 2

Me zbatimin e mbikëqyrjes së shoqërive, Agjencia e vlerëson sigurinë, stabilitetin, rrezikun dhe harmonizimin e veprimtarisë së shoqërisë me rregullat përmes:

- vlerësimin të aftësisë së shoqërisë për menaxhim me rreziqet, duke përfshirë dhe stafin organizativ, teknik dhe kuadrovik për ushtrimin e veprimtarive të sigurimeve;
- vlerësimin të masave për menaxhimin me rreziqet që i merr shoqëria;
- vlerësimin të përshtatshmërisë së tarifave të aplikuara të primeve, provigjonet e ndara teknike, mjetet të cila i mbulojnë provigjonet teknike, përshtatshmërinë e kapitalit, përshtatshmërinë e programit risigurues dhe mbulimi risigurues i masave të tjera me menaxhimin e rrezikut;
- vlerësimin i politikës së punës dhe strategjisë së shoqërisë;
- kontrollin e organizimit dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrave tregtare, dokumentacionin kontabilist dhe të punës, nga aspekti i saktësisë së tyre, azhurnimit dhe besueshmërisë në aplikimin e rregullave për kontabilitet dhe standarde kontabiliste dhe përpilim i raporteve financiare;
- vlerësimin e mënyrës së pranimit, trajtimit, likuidimit dhe pagesës së dëmeve dhe procedurës që përdoret me siguresit dhe përdoruesit të tjerë të sigurimit;
- kontrollin nëse raportet dhe të dhënat të cilat shoqëria i dorëzon në Agjenci janë dorëzuar në kornizat e afateve të caktuara dhe a janë përpiluar në përputhje me rregullat të cilat e rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë;
- vlerësimin nëse shoqëria i përmbush kushtet për ushtrimin e veprimtarive të sigurimeve, veprimtarive të brokerimit në sigurime dhe veprimtarive të përfaqësimit në sigurim, si dhe përshtatshmëri e veprimtarisë së shoqërisë me lejen, aktet e brendshme të shoqërisë dhe rregullat e miratuara nga ana e Agjencisë dhe institucioneve dhe organeve të tjera kompetente;

- vlerësim i funksionimit të sistemit të kontrolleve të brendshme, sistemit të udhëheqjes korporatave dhe sistemit të raportimit të udhëheqsisë;
- vlerësim i përzgjedhjes dhe mënyrës së kryerjes së auditimit nga ana e shoqërisë për auditim, si dhe raporti për auditim të kryer të veprimtarisë dhe raporteve vjetore financiare të shoqërisë;
- vlerësim i veprimtarisë dhe efikasitetit të auditimit të brendshëm;
- vlerësim i aplikimit të standardeve për siguri informative dhe planin për vazhdimësi në veprimtari.

MBIKËQYRJE E PËRHERSHME OFF-SITE

Neni 3

(1) Mbikëqyrja e përhershme off-site e veprimtarisë së shoqërisë paraqet sistem të veprimeve dhe proceseve që bazohet në ndjekjen e vazhdueshëm të veprimtarisë dhe ndryshimeve në veprimtarinë e shoqërisë, përmes analizës së raporteve dhe informatave të cilat shoqëria i dorëzon në Agjenci në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve, Ligjit për Sigurim të Detyrueshëm në Transport, rregullat nënligjore të miratuara në bazë të këtyre ligjeve dhe rregullave të tjera.

(2) Në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve, përveç raporteve dhe të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, mbikëqyrësit mund të kërkojnë nga shoqëria edhe të dhëna shtesë, raporte dhe deklarata nga të punësuarit e shoqërisë.

(3) Mbikëqyrësit nga neni 1 paragrafi (4) të kësaj rregulloreje, të cilët zbatojnë mbikëqyrje të përhershme off-site të veprimtarisë së shoqërisë:

- Vërtetojnë nëse të dhënat dhe raportet e caktuara janë dorëzuar në kornizat e afateve të caktuara, në formën e caktuar dhe mënyrën e caktuar;
- Vërtetojnë nëse janë logjike dhe të sakta shumat që janë cituar në raportet e caktuara të dorëzuara në Agjenci;
- Kryejnë analizë të trendeve në veprimtarinë e shoqërisë dhe e vlerësojnë stabilitetin dhe sigurinë e saj;

- Përpilojnë profile të rrezikut dhe strategji të mbikëqyrjes për shoqërinë në përputhje me aktet e brendshme të Agjencisë;
- Përpilojnë procesverbale për mospajtimet e konstatuara në veprimtarinë e shoqërisë;
- Kryejnë aktivitete të tjera në drejtim të përcjelljes së vazhdueshme të veprimtarisë së shoqërive nga aspekti i përputhjes së aktivitetit të shoqërisë me rregullat.

Neni 4

(1) Nëse gjatë zbatimit të mbikëqyrjes së vazhdueshme off-site vërtetohen mospërputhjet me rregullativën, mbikëqyrësit hartojnë konstatimin e tyre nga mbikëqyrja në formë të Procesverbalit nga mbikëqyrja e zbatuar off-site. Konstatimi i cili ka të bëjë me jorhamonizimin me rregullativën në Procesverbal shënohet me shënimin RL

(2) Nëse gjatë zbatimit të mbikëqyrjes së përhershme off-site, konstatohen mangësi në funksionimin e kontrolleve të brendshme në Shoqëri, mangësia e konstatuar në funksionimin e kontrolleve të brendshme në Procesverbalin e mbikëqyrjes së zbatuar në terren nga paragrafi (1) i këtij neni në shoqëri shënohet me shënimin KI.

(3) Procesverbali nga paragrafi (1) i këtij neni paraqet dokument zyrtar që përpilohet në bazë të rregullave të brendshme të Agjencisë.

(4) Nëse gjatë kohës së përpilimit të Procesverbalit nga mbikëqyrja e zbatuar off-site, shoqëria dëshmon në mënyrë të dokumentuar se mospërputhjet e caktuara të konstatuara gjatë zbatimit të mbikëqyrjes janë tejkaluara dhe e njëjta pranohet nga ana e mbikëqyrësve, në Procesverbal do të konstatohet mospërputhja duke theksuar se shoqëria ka ndërmarrë aktivitete për tejkalim të mospërputhjes për të cilën ka dorëzuar edhe dokumentin përkatës dëshmues. Nëse, shoqëria, pas përpilimit të Procesverbalit nga mbikëqyrja e zbatuar off-site, deri në momentin e përfundimit të tij, dorëzon dëshmi për harmonizimin me mospërputhjet e konstatuara në Procesverbal dhe kjo dëshmi pranohet nga ana e mbikëqyrësve, shoqëria do të njoftohet me shkrim.

(5) Shoqëria mund të citojë ose në mënyrë tjetër të theksojë përmbajtjen e Procesverbalit vetëm pas

pëlqimit me shkrim të dhënë nga Agjencia.

(6) Me përjashtim të paragrafit (5) të këtij neni, pëlqimi paraprak me shkrim nga Agjencia nuk kërkohet për citimin apo theksimin e përmbajtjes së Procesverbalit për qëllime të auditimit ligjor të shoqërive të sigurimeve.

(7) Procesverbali nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet tek anëtarët e organit udhëheqës të shoqërisë.

Neni 5

(1) Shoqëria e cila ka qenë lëndë e mbikëqyrjes ka të drejtë të dorëzojë vërejtje në raport me rezultatet e konstatuara në Procesverbal. Për vërejtjet shoqëria duhet të dorëzojë dëshmi të dokumentuara me të cilat do të vërtetojë vërejtjet. Përveç vërejtjeve ndaj rezultateve të caktuara të konstatuara në Procesverbal, shoqëria mund të dorëzojë edhe dëshmi se i ka shmangur paligjshmëritë e konstatuara në Procesverbal.

(2) Shoqëria duhet t'i dorëzojë vërejtjet sipas Procesverbalit në afat të cilin do ta caktojë Agjencia i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 e as më i gjatë se 15 ditë.

(3) Në kornizat e vërejtjeve të dorëzuara sipas Procesverbalit, shoqëria mund të kërkojë nga Agjencia edhe sqarime plotësuese në lidhje me bazat apo kriteret mbi të cilat Agjencia i bazon rezultat e konstatuara në Procesverbal.

(4) Mbikëqyrësit janë të detyruar t'ia dorëzojnë shoqërisë përgjigjen e vërejtjeve me çka dhe zyrtarisht do të llogaritet se Procesverbali nga mbikëqyrja e zbatuar off-site është përfundimtar.

(5) Nëse shoqëria nuk dorëzon vërejtje sipas Procesverbalit nga mbikëqyrja e zbatuar off-site në afatin nga paragrafi (2) të këtij neni, do të llogaritet se shoqëria pajtohet me rezultatet e konstatuara në Procesverbal, me çka dhe zyrtarisht Agjencia do të dorëzojë në shoqëri një shkresë me të cilën do të llogaritet se Procesverbali nga mbikëqyrja e zbatuar off-site është përfundimtar.

(6) Me përjashtim të paragrafit (5) të këtij neni, nëse gjatë zbatimit të mbikëqyrjes off-site nuk respektohen dispozitat e rregullativës për shumën e kapitalit, provigjonet teknike, fondet apo asetet që mbulojnë kapitalin ose provigjonet teknike si dhe kufizimet për kontributin në kapitali, pra kontributin e

fondeve që mbulojnë provigjonet teknike, i kontrollojnë dhe i konfirmojnë me shoqërinë nëpërmjet komunikimit elektronik, pas së cilës përpilojnë procesverbal i cili bëhet i formës së prerë apo përfundimtar në ditën e marrjes së procesverbalit nga shoqëria.

(7) Në rastet nga paragrafi (6) i këtij neni, me Procesverbalin nga zbatimi i mbikëqyrjes off-site shoqërisë i dorëzohet edhe urdhër/aktvendim për caktimin e masës së mbikëqyrjes.

(8) Pas përfundimit të Procesverbalit, kopja e tij dorëzohet tek organi mbikëqyrës i shoqërisë me kërkesë që ai të shqyrtohet nga ana e anëtarëve të organit mbikëqyrës në seancën e parë të ardhshme, por jo më vonë se 30 ditë nga dita e marrjes së përgjigjes nga Agjencia për përfundim të Procesverbalit.

(9) Organi mbikëqyrës i shoqërisë është i detyruar me shkrim ose në formë elektronike ta lajmërojë Agjencinë brenda tre ditëve para mbajtjes së seancës për vendin, mënyrën dhe kohën e mbajtjes së seancës në të cilën do të shqyrtohet Procesverbali nga mbikëqyrja e zbatuar off-site. Mbikëqyrësit mund të marrin pjesë në seancën e organit mbikëqyrës në të cilën shqyrtohet Procesverbali nga mbikëqyrja e zbatuar off-site. Brenda ditës së pestë pas miratimit të procesverbalit nga seanca e organit mbikëqyrës në të cilën shqyrtohet Procesverbali, Shoqëria është e detyruar në Agjenci të dorëzojë kopje nga ky Procesverbal.

(10) Autoriteti mbikëqyrës është i detyruar që një kopje e Procesverbalit të zbatimit të mbikëqyrjes off-site t'ia dorëzojë Shërbimit të Auditimit të Brendshëm të Shoqërisë.

(11) Nëse në Procesverbalin nga mbikëqyrja e zbatuar off-site janë të përmbajtura rezultatet të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e shoqërisë për auditim, fragment nga Procesverbali i dorëzohet edhe shoqërisë për auditim.

(12) Shoqëria e Auditimit nga paragrafi (10) i këtij neni ka të drejtë për vërejtje lidhur me fragmentin nga Procesverbali në afat prej tetë ditësh. Bashkangjitur me vërejtjet shoqëria për auditim duhet të dorëzojë dëshmi të dokumentuara me të cilat do të vërtetohen vërejtjet.

(13) Në kuadër të vërejtjeve të dorëzuara sipas fragmentit nga Procesverbali, shoqëria për auditim mund të kërkojë nga Agjencia edhe sqarime plotësuese në lidhje me bazat mbi të cilat Agjencia i bazon rezultatet e konstatuara në fragmentin nga Procesverbali.

(14) Mbikëqyrësit janë të detyruar t'i dorëzojnë shoqërisë për auditim përgjigje të vërejtjeve me çka fragmenti nga Procesverbali do të llogaritet si përfundimtar.

(15) Nëse shoqëria për auditim nuk dorëzon vërejtje sipas fragmentit nga Procesverbali nga mbikëqyrja e zbatuar off-site në afatin nga paragrafi (10) i këtij neni, do të llogaritet se shoqëria për auditim pajtohet me rezultatet e konstatuara në fragmentin nga Procesverbali me çka edhe zyrtarisht Agjencia do të dorëzojë shkresë në shoqërinë për auditim me të cilën do të llogaritet se fragmenti nga Procesverbali i mbikëqyrjes së zbatuar off-site është përfundimtar.

(16) Agjencia do ta lajmërojë Institutin e auditorëve të autorizuar dhe Këshillin për avancim dhe mbikëqyrje të auditimit për korrespondencën e bërë me shkrim me shoqërinë për auditim, nga paragrafët (11), (12), (13), (14), dhe (15) të këtij neni.

MBIKËQYRJA NË TERREN

Neni 6

(1) Mbikëqyrja në terren e veprimtarisë së shoqërive paraqet sistem të veprimeve dhe proceseve përmes të cilave vërtetohet siguria, stabiliteti, rreziku dhe përputhja e shoqërisë me rregullat, me çka aplikohen rregullat e brendshme dhe procedurat e miratuara nga ana e Agjencisë.

(2) Mbikëqyrjen në terren nga paragrafi (1) të këtij neni e zbatojnë mbikëqyrësit.

(3) Mbikëqyrja në terren kryhet sipas Planit për mbikëqyrje on-site të caktuar paraprakisht i aprovuar nga ana e Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë.

(4) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, mbikëqyrja on-site zbatohet edhe sipas nevojës në rastet në vijim:

- nëse përmes zbatimit të mbikëqyrjes së përhershme off-site të veprimtarisë së shoqërive vërtetohet përkeqësim i trendeve në veprimtarinë e shoqërisë, që mund të ndikojë në mënyrë negative mbi sigurinë, stabilitetin dhe rrezikun e saj;

- nëse është e nevojshme të vërtetohet përgjegjësia e shoqërisë në raport me masat e ndërmarra të mbikëqyrjes nga ana e Agjencisë dhe
- për shkak të grumbullimit, përpilimit dhe analizës së të dhënave të nevojshme për kryerjen e funksioneve të Agjencisë.

(5) Plani për mbikëqyrje në terren përcaktohet në bazë të profileve të rrezikut dhe strategjive mbikëqyrëse të vërtetuara në kornizat e përcjelljes së vazhdueshme off-site të veprimtarisë së shoqërive, pra, bazuar në një analizë financiare të parametrave sasiorë (për aftësinë paguese, likuiditetin, përfitueshmërinë dhe parametra të tjerë sasiorë) si dhe të dhëna cilësore për secilën shoqëri (opinionit i audituesit të jashtëm të pavarur, raportet e auditimit të brendshëm, opinionit të aktuarit të autorizuar, programet e risigurimit dhe statistikave të risigurimeve, raportet për kundërshtimet e paraqitura dhe të zgjidhura ndaj shoqërisë në bazë të dëmeve, raportet për ankesat e paraqitura në Agjenci, vlerësimi i ekspertëve të mbikëqyrësve (kanalet e shitjes, tendenca e pazakontë e një pozicioni të caktuar në bilance, rregullimi i vlerës së mjeteve të arkëtueshme, vlera e komisioneve etj.) Janë marrë parasysh edhe mbikëqyrjet në terren të kryera më parë nga Agjencia, pra shpeshësia e mbikëqyrjeve në terren për subjekt të mbikëqyrur, por edhe serioziteti i konstatimeve dhe masave që kanë rezultuar. Krijimi i planit për mbikëqyrjen në terren është ndikuar edhe nga kuadri i ri rregullator, nga ligjvënës dhe/ose nga Agjencia.

Neni 7

(1) Para fillimit të mbikëqyrjes on-site, Agjencia dorëzon në shoqëri Vendim për autorizim të personave për zbatim të mbikëqyrjes on-site në afat që nuk është më i shkurtër se 15 ditë para fillimit të mbikëqyrjes on-site.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, Agjencia dorëzon Vendim për autorizim të personave për zbatim të mbikëqyrjes së pjesërisht on-site në afat që nuk është më i shkurtër se 8 ditë para fillimit të mbikëqyrjes.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni, Agjencia, Vendimin për autorizim të personave për zbatim të mbikëqyrjes on-site mund ta dorëzojë edhe në vendngjarje, pak para fillimit të vetë mbikëqyrjes on-site nëse nuk ka qenë e mundur që qëllimet e mbikëqyrjes on-site të realizohen në

mënyrë tjetër.

(4) Aktvendimi për autorizim të personave për zbatim të mbikëqyrjes në terren nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni përmban të dhëna për lëndën e mbikëqyrjes, mbikëqyrësin e autorizuar i cili e koordinon ekipin mbikëqyrës dhe anëtarët e ekipit të mbikëqyrjes q do ta zbatojnë mbikëqyrjen në terren.

(5) Së bashku me Aktvendimin për autorizim të personave për zbatim të mbikëqyrjes në terren, Agjencia dorëzon në shoqëri edhe lajmërim në të cilin përcaktohen të dhënat dhe informatat të cilat shoqëria duhet t'i dorëzojë në Agjenci para fillimit të mbikëqyrjes në terren dhe të dhënat dhe informatat të cilat shoqëria duhet t'i përgatitë deri në ditën e fillimit të mbikëqyrjes në terren.

(6) Të dhënat dhe informatat të cilat shoqëria duhet t'i dorëzojë në Agjenci para fillimit të mbikëqyrjes në terren në përputhje me paragrafin (5) të këtij neni duhet të jenë të dorëzuara në afat që nuk është më i shkurtë se 8 e as më i gjatë se 15 ditë pas marrjes së aktvendimit për autorizim të personave nga paragrafi (1) i këtij neni.

(7) Të dhënat dhe informatat të cilat shoqëria duhet t'i dorëzojë në Agjenci në përputhje me paragrafin (5) të këtij neni duhet të jenë të plota, të sakta dhe përfundimtare dhe shoqëria nuk mund t'i ndryshojë gjatë mbikëqyrjes në terren.

Neni 8

Shoqëria është e detyruar në përputhje me procedurat e veta të sigurisë, mbikëqyrësve t'u sigurojë akses tek të gjitha hapësirat, t'ua japë në shqyrtim tërë dokumentacionin e disponueshëm, duke përfshirë edhe të dhënat të cilat ruhen në mënyrë elektronike, si dhe të sigurojë dokumentacion të plotë të cilin do ta kërkojnë mbikëqyrësit, duke përfshirë deklarata me shkrim nga ana e anëtarëve të organit drejtues dhe personave të tjerë me të drejta dhe autorizime të veçanta, me sqarim për pyetjet që kanë rëndësi për vërtetimin e sigurisë, stabilitetit dhe rrezikut të shoqërisë dhe përputhja e shoqërisë me rregullat.

Neni 9

(1) Nëse gjatë zbatimit të mbikëqyrjes në terren vërtetohet nevoja për zgjerimin e lëndës së mbikëqyrjes, në përputhje me rregullat e brendshme dhe procedurat për veprimtarinë e Agjencisë, kryetari/anëtari i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë do të aplikojë ndryshim dhe plotësim të autorizimit për zbatim të mbikëqyrjes.

(2) Nëse të dhënat e kërkuara dhe informatat e nevojshme për zbatim të mbikëqyrjes nuk janë të përgatitura në ditën e fillimit të mbikëqyrjes në terren, gjegjësisht të dhënat dhe informatat për të cilat është kërkuar që të dorëzohen në Agjenci, para fillimit të mbikëqyrjes nuk janë dorëzuar në kornizat e afatit të parashikuar, Agjencia do të ndërpresë mbikëqyrjen me aktvendim me konkluzion apo konstatim.

(3) Mbikëqyrja në terren do të ndërpritet dhe nëse e njëjta zhvillohet me vështirësi për shkak të evidencës jo të rregullt, mungesës apo mosdorëzimit të dokumentacionit, mosbashkëpunimi i organeve të shoqërisë apo nëse në ndonjë mënyrë tjetër pengohet ushtrimi i mbikëqyrjes.

Neni 10

(1) Pas mbikëqyrjes të zbatuar në terren, mbikëqyrësit përpilojnë Procesverbal nga mbikëqyrja e zbatuar në terren. Nëse gjatë kohës së përpilimit të Procesverbalit nga mbikëqyrja e zbatuar në terren, shoqëria në mënyrë të dokumentuar dëshmon se mospajtimet e caktuara të konstatuara gjatë zbatimit të mbikëqyrjes janë tejkalar dhe e njëjta është e pranuar nga ana e mbikëqyrësve, në Procesverbal do të konstatohet mospërputhje duke cituar se shoqëria ka marrë aktivitete për tejkalimin e mospajtimeve për të cilat ka dorëzuar edhe dokumentacion përkatës dëshmi. Nëse shoqëria, pas përgatitjes së Procesverbalit nga mbikëqyrja e zbatuar on-site, deri në momentin e përfundimit të tij, dorëzon dëshmi për përputhje me mospajtimet e konstatuara në Procesverbal dhe dëshmitë e njëjta janë të pranuar nga ana e mbikëqyrësve, shoqëria do të njoftohet me shkrim. Konstatimi që i referohet mosrespektimit të rregullativës ligjore në procesverbal shënohet me simbolin RL.

(2) Nëse gjatë zbatimit të mbikëqyrjes permanente of-site konstatohen dobësi në funksionimin e kontrolleve të brendshme në shoqëri, dobësia e konstatuar në funksionimin e kontrolleve të brendshme në Procesverbalin nga zbatimi i mbikëqyrjes off-site nga paragrafi (1) i këtij neni në shoqëri shënohet me emërtimin apo simbolin KI.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, për mbikëqyrjen e zbatuar on-site nga neni 6 paragrafi (4) të kësaj rregullore, mbikëqyrësit përpilojnë procesverbal i cili nuk dorëzohet tek shoqëria.

(4) Procesverbali nga paragrafi (1) i këtij neni paraqet dokument zyrtar i cili përpilohet në bazë të rregullave të brendshme dhe procedurave të Agjencisë.

(5) Procesverbali nga paragrafi (1) i këtij neni përmban informata, të dhëna dhe shqyrtime të mbikëqyrësve për mënyrën se si shoqëria menaxhon me rreziqet dhe për përputhshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë me rregullat.

(6) Shoqëria mund të citojë ose në mënyrë tjetër të theksojë përmbajtjen e procesverbalit vetëm nëse paraprakisht ka marrë leje me shkrim nga Agjencia për nevojat e kryerjes së auditimit të raporteve vjetore financiare të shoqërisë, për analizë të thellë të shoqërisë dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.

(7) Me përjashtim të paragrafit (6) të këtij neni, pëlqimi paraprak me shkrim nga Agjencia nuk është i nevojshëm për të cituar ose përmendur përmbajtjen e procesverbalit për qëllime të auditimit juridik të shoqërive të sigurimeve.

(8) Procesverbali nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet tek anëtarët e organit udhëheqës të shoqërisë.

(1) Anëtarët e organit drejtues të shoqërisë janë të detyruar ta shqyrtojnë procesverbalin nga zbatimi i mbikëqyrjes në terren dhe në Agjenci të dorëzojnë kopjen nga procesverbali i seancës së organit drejtues në të cilën është shqyrtuar ky procesverbal.

Neni 11

(1) Shoqëria e cila ka qenë lëndë e mbikëqyrjes ka të drejtë të dorëzojë vërejtje në raport me rezultatet e konstatuara në Procesverbal. Bashkangjitur me vërejtjet shoqëria duhet të dorëzojë dëshmi të dokumentuara me të cilat do t'i vërtetojnë vërejtjet. Përveç vërejtjeve për rezultate të caktuara të konstatuara në procesverbal, shoqëria mund të dorëzojë edhe dëshmi se i ka shmangur paligjshmëritë e konstatuara në Procesverbal.

(2) Shoqëria mund t'i dorëzojë vërejtjet në Procesverbal në afat të cilin do ta caktojë Agjencia e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se 8 e as më e gjatë se 15 ditë.

(3) Në kornizat e vërejtjeve të dorëzuara sipas rezultateve të ndara nga Procesverbali, shoqëria mund të

kërkojë nga Agjencia edhe sqarime plotësuese në lidhje me bazat mbi të cilat Agjencia i bazon rezultatet e konstatuara në Procesverbal.

(4) Mbikëqyrësit janë të detyruar t'i dorëzojnë shoqërisë përgjigje për vërejtjet me çka edhe zyrtarisht llogaritet se mbikëqyrja on-site është kryer ndërsa Procesverbali do të llogaritet si përfundimtar.

(5) Nëse shoqëria nuk dorëzon vërejtje në Procesverbal nga mbikëqyrja e zbatuar on-site në afatin nga paragrafi (2) të këtij neni, do të llogaritet se shoqëria pajtohet me rezultatet e konstatuara në Procesverbal, me çka edhe zyrtarisht Agjencia do të dorëzojë në shoqëri shkresë me të cilën do të llogaritet se Procesverbali nga mbikëqyrja e zbatuar on-site është përfundimtar.

(6) Me përjashtim të paragrafit (5) të këtij neni, nëse mbikëqyrësit gjatë zbatimit të mbikëqyrjes në terren konstatojnë mosrespektim të dispozitave të rregullores që i referohen shumës së kapitalit ose shumës së mjeteve për mbulimin e provigjoneve teknike, respektivisht shkelje të limiteve të investimit të kapitalit ose për investimet e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, mbikëqyrësit menjëherë hartojnë një raport për shoqërinë pas një konfirmimi elektronik të mëparshëm nga shoqëria për mospërputhjet e konstatuara. Procesverbali bëhet i formës së prerë apo është përfundimtar nga dita e marrjes së tyre nga shoqëria. Mbikëqyrja në terren do të vazhdojë edhe në pjesën tjetër që i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe për të do të ketë procedurë të rregullt për dorëzimin e Procesverbalit.

(7) Në rastet e përcaktuara në paragrafin (6) të këtij neni, me paraqitjen e Procesverbalit për zbatimin e mbikëqyrjes në terren, shoqërisë i dorëzohet edhe urdhër/aktvendim për caktimin e masës së mbikëqyrjes.

(8) Pas përfundimit të Procesverbalit, kopja e tij dorëzohet tek organi mbikëqyrës i shoqërisë me kërkesë që ai të shqyrtohet nga ana e anëtarëve të organit mbikëqyrës në seancën e parë të ardhshme, por jo më vonë se 30 ditë nga pranimi i përgjigjes nga Agjencia për përfundimin e Procesverbalit.

(9) Organi mbikëqyrës i shoqërisë është i detyruar të lajmërojë Agjencinë me shkrim ose në formë elektronike brenda tre ditëve para mbajtjes së seancës për vendin, mënyrën dhe kohën e mbajtjes së seancës në të cilën do të shqyrtohet Procesverbali nga mbikëqyrja e zbatuar në terren. Mbikëqyrësit mund të jenë prezent në seancën e organit mbikëqyrës ku shqyrtohet Procesverbali nga mbikëqyrja e

zbatuar në terren. Brenda ditës së pestë pas miratimit të procesverbalit nga seanca e organit mbikëqyrës në të cilën është shqyrtuar Procesverbali, shoqëria është e obliguar të dorëzojë kopjen e këtij procesverbali në Agjenci.

(10) Organi mbikëqyrës është i obliguar që një kopje të Procesverbalit të zbatimit të mbikëqyrjes në terren t'ia dorëzojë Shërbimit të auditimit të brendshëm të shoqërisë.

(11) Nëse në Procesverbalin nga mbikëqyrja e zbatuar on-site janë të përmbajtura rezultatet të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e shoqërisë për auditim, fragmenti nga Procesverbali dorëzohet edhe në shoqërinë për auditim.

(12) Fragmenti nga Procesverbali nga paragrafi (11) i këtij neni dorëzohet tek shoqëria për auditim në momentin e njëjtë kur Procesverbali nga mbikëqyrja e zbatuar on-site dorëzohet tek anëtarët e organit drejtues të shoqërisë.

(13) Shoqëria për auditim nga paragrafi (11) i këtij neni ka të drejtë në vërejtje sipas fragmentit nga Procesverbali në afat prej 8 ditësh. Bashkangjitur me vërejtjet shoqëria për auditim duhet të dorëzojë dëshmi të dokumentuara me të cilat do të vërtetohen vërejtjet.

(14) Në kornizat e vërejtjeve të dorëzuara sipas fragmentit nga Procesverbali, shoqëria për auditim mund të kërkojë nga Agjencia edhe sqarime plotësuese në lidhje me bazat mbi të cilat Agjencia i bazon rezultatet e konstatuara në Procesverbal.

(15) Mbikëqyrësit janë të detyruar t'i dorëzojnë shoqërisë për auditim përgjigje për vërejtët me çka fragmenti nga Procesverbali do të llogaritet përfundimtar.

(16) Nëse shoqëria për auditim nuk dorëzon vërejtje sipas fragmentit nga Procesverbali nga mbikëqyrja e zbatuar në terren në afatin nga paragrafi (13) të këtij neni, do të llogaritet se shoqëria për auditim pajtohet me rezultatet e konstatuara në Procesverbal, me çka edhe zyrtarisht Agjencia do të dorëzojë shkresë deri tek shoqëria për auditim me të cilën do të llogaritet se fragmenti nga Procesverbali nga mbikëqyrja e zbatuar on-site është përfundimtar.

(17) Agjencia do të lajmërojë Institutin e auditorëve të autorizuar dhe Këshillin për avancim dhe mbikëqyrje të auditimit për korrespondencën e bërë me shkrim, nga paragrafët (11), (12), (13), (14), (15) dhe (16) të këtij neni, me shoqërinë e auditimit.

MASAT E MBIKËQYRJES

Neni 12

Nëse gjatë zbatimit të mbikëqyrjes vërtetohet se shoqëria nuk i respekton dispozitat nga rregullativa (në tekstin që vijon: paligjshmëri dhe/apo parregullsi të vërtetuara), Agjencia mund t'i shqiptojë masat vijuese të mbikëqyrjes:

1. Urdhër për mënjanimin e paligjshmërive;
2. Përcaktim të masave plotësuese të mbikëqyrjes;
3. Revokimi i lejes;
4. Përfshirje e drejtorisë së veçantë;
5. Zbatimi i likuidimit të shoqërisë;
6. Dorëzim i propozimit për hapje të procedurës falimentuese të shoqërisë.

(2) Përveç masave të vërtetuara në paragrafin (1) të këtij neni, Agjencia mund t'i urdhërojë shoqërisë të ndërmarrë dhe masa të tjera në funksionin e avancimit të punës së shoqërisë dhe përforcimin e sistemit të kontrolleve të brendshme në shoqëri.

(3) Agjencia, përcakton masa të mbikëqyrjes të cilat janë më adekuate dhe më përkatëse për arritjen e qëllimeve rregullatore, duke mbajtur llogari për natyrën, peshën dhe shpeshtësinë e paligjshmërive dhe/apo parregullsive të vërtetuara.

(4) Agjencia mund të përcaktojë një apo më shumë masa të mbikëqyrjes.

(5) Masat e mbikëqyrjes të vërtetuara në paragrafin (1) të këtij neni dërgohen në formë Aktvendimi dhe/ose Urdhri (në tekstin që vijon: akt i Agjencisë).

(6) Nëse deri në ditën e miratimit të aktit të Agjencisë me të cilin shqiptohet masa e mbikëqyrjes shoqëria e ka mënjanuar paligjshmërinë për të cilën në përputhje me rregullativën është parashikuar masa nga paragrafi (1) pika 1) e këtij neni, Agjencia nuk do të shqiptojë masë të mbikëqyrjes për shoqërinë.

(7) Për paligjshmëritë për të cilat në përputhje me rregullativën është parashikuar masë kundërvajtje, para vendosjes së procedurës kundërvajtëse, nëpunësi i autorizuar në Agjenci i propozin shoqërisë- autor të kundërvajtjes, procedurn e barazimit apo shlyerjes me lëshimin e urdhër-pagesës për kundërvajtje.

(8) Procedura e barazimit zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve, Ligjit për Sigurim të Detyrueshëm në Transport dhe Ligjit për Kundërvajtje.

(9) Për shoqëritë e brokerimit në sigurime dhe shoqëritë për përfaqësim në sigurime, si dhe për personat nga neni 1 paragrafi (3), Agjencia mund t'i shqiptojë vetëm masat e mbikëqyrjes nën pikën 1), 2) dhe 3) të paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 13

(1) Shoqëria është e detyruar në afatin e caktuar në aktin e Agjencisë t'i mënjanojë paligjshmëritë dhe/apo parregullsitë e vërtetuara dhe të dorëzojë në Agjencia raport për mënjanimin e paligjshmërive dhe/apo parregullsive.

(2) Raporti do të përmbajë sqarim të masave të ndërmarra dhe do të jetë i bashkangjitur me dokumentacion dëshmi se paligjshmëritë dhe/apo parregullsitë e vërtetuara janë mënjanuar.

(3) Nëse Agjencia vërteton paligjshmëri të caktuara gjatë mbajtjes së evidencës kontabiliste, administrative apo evidence të një veprimtarie tjetër, do t'i urdhërojë shoqërisë që Raporti për mënjanimin e paligjshmërive dhe/apo parregullsive të jetë i bashkangjitur me mendimin pozitiv nga ana e auditorit të autorizuar se paligjshmëritë dhe/apo parregullsitë janë mënjanuar.

(4) Në bazë të Raportit për mënjanimin e paligjshmërive/parregullsive, Agjencia mund të zbatojë mbikëqyrje shtesë të veprimtarisë së shoqërisë në vëllim i cili është i domosdoshëm për vërtetimin nëse janë mënjanuar paligjshmëritë dhe/apo parregullsitë e konfirmuara.

(5) Nëse në bazë të Raportit për mënjanimin e paligjshmërive/parregullsive nga paragrafi (1) dhe/apo mbikëqyrja e zbatuar shtesë nga paragrafi (4) i këtij neni vërtetohet se shoqëria i ka mënjanuar paligjshmëritë dhe/apo parregullsitë e konfirmuara, Agjencia do ta informojë subjektin e mbikëqyrur se mbyllet procedura e mbikëqyrjes.

(6) Nëse në bazë të Raportit për mënjanimin e paligjshmërive/parregullsive nga paragrafi (1) dhe/apo mbikëqyrja e zbatuar shtesë nga paragrafi (4) të këtij neni vërtetohet se shoqëria nuk i ka mënjanuar paligjshmëritë dhe/apo parregullsitë e konfirmuara, Agjencia do të marrë masa të tjera në përputhje me ligjin.

Neni 14

(1) Shoqëria mund të dorëzojë Ankimim kundër Urdhrit për mënjanimin e paligjshmërive në afat prej 8 ditëve nga dorëzimi i Urdhrit.

(2) Nëse ankimimi është dorëzuar në afatin nga paragrafi (1) të këtij neni, afati përfundimtar për mënjanimin e paligjshmërive i caktuar në këtë Urdhër do të vazhdohet për periudhën nga dorëzimi i ankimit deri në sjelljen e vendimit në lidhje me këtë kundërshtim.

(3) Në përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, në rast kur për shkak të natyrës së paligjshmërive kryerja e Urdhrit nuk mund të anulohet, Agjencia mundet në urdhër të theksojë se ankimimi nuk e anulon ekzekutimin e urdhrit.

(4) Pas ankimit nga paragrafi (1) i këtij neni Agjencia me vendim do të vendosë që në një afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ankimit, me çka Urdhri do të jetë përfundimtar.

(5) Me vendimin nga paragrafi (4) i këtij neni, Agjencia mund ta refuzojë apo mos e pranojë ankimin, ta ndryshojë Urdhrin apo ta anulojë Urdhrin.

(6) Kundër Aktvendimit nga paragrafi (4) dhe Aktvendimit për masë shtesë të mbikëqyrjes, shoqëria mund të fillojë kontest administrativ para gjykatës kompetente.

MBAJTJA E KONTAKTEVE ME ANËTARËT E ORGANEVE DREJTUESE TË SHOQËRISË, SHËRBIMIN PËR AUDITIM TË BRENDSHËM DHE ME SHOQËRINË PËR AUDITIM

Neni 15

(1) Mbikëqyrësit nga neni 1 paragrafi (4) i kësaj rregulloreje para fillimit të mbikëqyrjes në terren, mund të mbajnë takim pune me shërbimin për auditim të brendshëm dhe me shoqërinë për auditim të përcaktuar nga shoqëria.

(2) Në takim diskutohet për rezultatet nga aktivitetet e Shërbimit për auditim të brendshëm dhe shoqërisë për auditim.

(3) Mbikëqyrësit nga neni 1 paragrafi (4) i kësaj rregulloreje, mund të mbajnë takime pune me anëtarët e organit drejtues, anëtarët e organit mbikëqyrës, auditorin e autorizuar të shoqërisë dhe shoqërinë për auditim të përcaktuar nga shoqëria.

(4) Në këto takime diskutohet dhe shkëmbehen të dhëna dhe informata për veprimtarinë e shoqërisë nga të cilat mbikëqyrësit duhet të fitojnë informata më të afërta për veprimtarinë e shoqërisë, udhëheqjes korporative, rreziqeve në veprimtari, menaxhimin me rreziqet, ndryshimet në politikën e punës dhe strategjinë e shoqërisë si dhe sigurinë dhe stabilitetin e shoqërisë.

BASHKËPUNIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMATAVE ME ORGANE TË TJERA MBIKËQYRËSE

Neni 16

Mbikëqyrësit nga neni 1 paragrafi (4) i kësaj rregulloreje gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së shoqërisë, sipas nevojës, bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë të dhëna dhe informata me organe të tjera mbikëqyrëse dhe institucione të tjera nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe nga jashtë.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

**Neni 12 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”. nr.
59/2017)**

Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Neni 14 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 63/2021)

Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Kryetar i Këshillit të Ekspertëve

Kërste Shajnoski